



Pranuar / Dorezuar Prilazhenje/Pristazhje Received/Deliverty	02.08	2023	3	viti god year
Organ /Mjesta Organ /Jedinita Org./Unit	Nr Prot br Prot Prot No	Shkollja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	5496	2023	113	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.873/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës me numër A.nr.873/2023 të datës 21.06.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë nga në çështjen juridike "kontestim konkursi", në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 02.08.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.873/2023 të datës 21.06.2023 të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi me datë 21.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4860/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Konkursit të datës 21.12.2022 për pozitën "Zyrtar Administrativ", i shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme, me pretendimet ankimore se ka pas padrejtësi dhe parregullsi lidhur me pranimin e punëtorëve në këtë konkurs.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale lidhur me çështjen, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Nga shkresat e lëndës rrjedhë së Ministria e Punëve të Brendshme duke u bazuar në nenin 79, nenin 80 dhe nenin 81 paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, me datë 04.11.2022 ka shpallur Konkursin për



nëpunës administrativ dhe mbështetës për pozitën " Zyrtar Administrativ", njëqind (100) pozita, me afat prej një viti.

Me dispozitat e Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht me nenin 2 është përcaktuar se: "...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike. Ndërsa me nenin 82 po të këtij ligji është përcaktuar se " Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës" rrjedhimisht po mbi këtë bazë ligjore është bërë edhe shpallja e Konkursit të datës 21.12.2022 për nëpunës administrativ dhe mbështetës për pozitën " Zyrtar Administrativ".

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, konstaton se nëpunësi *administrativo-teknik dhe mbështetës* fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të filloj kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafit 2 të Kushtetues së Kosovës si dhe nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil, rrjedhimisht Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent që të shqyrtoj ankesat lidhur me kontestet e marrëdhënies së punës së nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, andaj, mbi këtë bazë të konstatimit rrjedh se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit


Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.873/2023 të datës 21.06.2023, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit publik, i njëjti udhëzohet për inicim të kontestit gjyqësor në gjykatën kompetente në pajtim me dispozitat e Ligjit të Punës, pasi që lënda nuk mund të bartet të gjykata kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.873/2023.

Ardita Perçuku-Shyti  
  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI  
  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

